

Tepelenë, më 16.11.2017

## **KONTRATË SHITJE KUOTASH**

Sot me datë 16.11.2017, në Tepelenë, lidhet kjo Kontratë për Shitje Kuotash (më poshtë referuar si Kontrata), midis palëve:

- **SHITËSI:**

Z. **HEKURAN HOXHA**, i biri i Faik, i dtl.16.05.1960 lindur në Plashnik Berat dhe banues në Tepelenë, shtetas Shqiptar me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftim ID nr.032567671 dhe nr.Personal G00516005D. Mbajtëse e 1(një) kuote, me vlerë 50.000 lekë (pesëdhjetëmijë), pra 50% të Kapitalit Themeltar të Shoqërisë.

dhe

- **BLERËSI:**

Z. **FATJON HOXHA**, i biri i Hekuran i dtl.31.05.1988 lindur në Berat dhe banues në Berat, shtetas Shqiptar me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i Pasaportës me Nr. BE8454570 dhe Numër Personal I80531002S.

### **PARASHTRIME:**

- 1) NG STRUCTURES Shpk është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar organizuar sipas dispozitave ligjore e nënligjore të ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar dhe ligjeve të tjera të fushës në Republikën e Shqipërisë me seli në Tepelenë dhe NUIS: L79326502O e cila zhvillon aktivitetet në fushën e ndërtimit (zbatimit të punimeve) dhe studim-projektimit etj.
- 2) Në datën e sotme kapitali i regjistruar i shoqërisë NG STRUCTURES Shpk është i barabartë me 100 000 (njëqind mijë) lekë, i ndarë në 2 (dy) kuota me vlerë të barabartë, secila 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë përfaqëson 50% të kapitalit.
- 3) Shitësit z.HEKURAN FAIK HOXHA në cilësinë e ortakut, përmes Vendimit Nr.4 datë 16.11.2017 të Asamblesë së Përgjithshme synon t'i transferojnë kuotën e tij, Blerësit z.FATJON HOXHA.

Për sa më sipër, palët bien dakort si më poshtë:





### Neni 1

#### Objekti i kontratës

- 1.1 Shitësi pranon t'i shesë Blerësit dhe Blerësi pranon të blejë nga Shitësi, 1 (një) kuotë që përbën 50 % të kapitalit të regjistruar të shoqërisë NG STRUCTURES Shpk.
- 1.2 Si pasojë e transferimit të Kuotës nga Shitësi tek Blerësi, sipas kësaj kontrate Shoqëria do të ketë 2 (dy) ortakë (Znj.Aleksandra Bami dhe z.Fatjon Hoxha) të cilët do të zotërojnë pjesë të barabarta të kapitalit themeltar të shoqërisë, përkatësisht nga 50% të kapitali themeltar.

### Neni 2

#### Çmimi

- 2.1 Vlera në lekë e kuotës që do të shitet e cila përfaqëson 50% të kapitalit themeltar të Shoqërisë është 50 000 (pesëdhjetëmijë) lekë.

### Neni 3

#### Hyrja në fuqi

- 3.1 E drejta e pronësisë së Shitësit mbi Kuotën që ai zotëron do t'i transferohet Blerësit në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate.

### Neni 4

#### Dizpozita të përgjithshme

- 4.1 Marrëdhënia midis ortakëve të shoqërisë do t'i nënshtrohet rregullimeve të përcaktuara në Statutin e Shoqërisë njëkohësisht, në dispozitave ligjore dhe nënligjore në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

### PALËT:

#### SHITËSI

HEKURAN HOXHA



#### BLERËSI

FATJON HOXHA

